

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6813  
E martë, 31 janar 2023  
çmimi 0.40 €

Me 80 centë mund të udhëtoni 24 orë me autobusët e Trafikut Urban | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FRIEDRICH-EBERT-STIFTUNG (FES) PUBLIKON ZYRTARISHT DRAFTSTATUTIN PËR FORMIMIN E ASOCIACIONIT DHE KOMPETENCAT QË DO TË KETË

## DRAFTSTATUTI NGA FES-i: ASOCIACIONI NË PËRPUTHJE ME KUSHTETUTËN, ME SIMBOLE TË VETA, KUVEND E KRYETAR



Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), në bashkëpunim me Institutin Evropian për Paqe, kanë publikuar versionin e draftstatutit për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Aty parashihet

që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë të formohet në përputhje me Kushtetutën dhe sistemin juridik të Kosovës. I përbërë nga 7 kapituj dhe 18 nene, ky draftstatut parasheh mënyrën e

themelimit, strukturën organizative, marrëdhëniet me autoritetet qendrore, rregullimin ligjor, buxhetin, si dhe aspekte të tjera të funksionimit të këtij asociacioni, përfshirë simbolet

## MUSTAFA DHE SHALA: QEVERIA KURTI PO E ZHYTË VENDIN NË KRIZË | FAQE 3



## NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR PORTIN E DURRËSIT | FAQE 2

## OPINION

KOSOVA DREJT FEDERALIZIMIT; NJOHJA RECIPROKE AS NË QENDËR E AS NË THEMBËR!



F. 6-7

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

## AKTUALE



TË PAKTËN 37 TË VDEKUR NGA NJË SULM VETËVRSASË NË NJË XHAMI PAKISTANEZE | F. 2

POLICIA SEKUESTRON MBI 100 KILOGRAMË MARIJUANË | F. 5

## EKONOMI

BORDI I AKP-SË NJOFTOHET ME PËRGATITJEN E N. SH. "BREZOVIKA" PËR SEZONIN DIMËROR | F. 8

EKONOMISTËT THONË SE MOSSTABILITETI POLITIK NË KOSOVË PARAQET PROBLEM PËR INVESTIMET E HUAJA | F. 8

## SPORT



TRI SFIDA INTERESANTE NË LIGËN UNIKE | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Nënshkruhet marrëveshja për Portin e Durrësit

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

**TI RANË, 30 JANAR** - Marrëveshja përfundimtare për zhvillimin e projektit "Durrës Yacht & Marina" është firmosur këtë të hënë nga Qeveria e Shqipërisë dhe "Eagle Hills Real Estate". Marrëveshja u firmos në Pallatin e Kongreseve nga zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, Besart Kadia, investitori Muhammed El Alabbar dhe Erlis Hereni, drejtor i Agjencisë për realizimin e këtij projekti. Kryeministri Edi Rama u shpreh se ky është një kapitull i ri për turizmin në vendin tonë dhe hyn në ekonominë shqiptare si një lokomotivë që do të sjellë një impakt të jashtëzakonshëm. "Gati me të gjitha tanimë për projektin më të rëndësishëm turistik, investimi më i madh i huaj në historinë tonë dhe ndoshta të rajonit, i cili do ta transformojë rrënjësisht Durrësin, duke e vendosur në radhën kryesore të destinacioneve turistike në Mesdhe, me një impakt të thellë ekonomik jo vetëm për qytetin bregdetar po për të gjithë vendin", ka theksuar Rama. Ai ka thënë se nënshkrimi i

marrëveshjes për zhvillimin e projektit "Durrës Yacht & Marina" është finalizimi i një rruge të gjatë pune voluminoze, në aspektin tekniko-ligjor, me një investitor të madh strategjik, prestigji i të cilit është botërisht i njohur. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Belinda Balluku, u shpreh se tashmë nis faza më e vështirë, ajo e implementimit në terren. "Ky projekt do të ndryshojë njëherë e përgjithmonë pamjet e turizmit jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin. Interesi ka qenë shumë i madh nga qytetarë nga diaspora dhe e gjithë bota. Nuk ka qenë e lehtë të negocionim. Ecnim në një rrugë krejtësisht të re. Tashmë kemi dhe projekte të tjera të kësaj natyre. Realizimi i projektit do të vërtetojë se kemi bërë zgjedhjen e duhur. Ky projekt i këtij lloji me PPP parashikon që aksionari ka të gjitha përfitimet e një aksionari në të ardhura. 45 % e hapësirës së portit aktual i mbetet shtetit", ka deklaruar Balluku. Investitori Mohamed El Alabbar ka deklaruar se në Durrës do të implementohen teknologjitë më të fundit që nuk janë përdorur as në Dubai dhe



premti se nuk do të zhgënjë në rezultatet e punës. "Disa nga gjërat që po bëhen këtu janë më të përparura se në Dubai, ideja e hapjes së vendeve të punës është shumë e rëndësishme. Njerëzit flasin për qytete inteligjente, por askush nuk e ka bërë, ndërsa në Durrës do ta bëjmë këtë gjë. E gjitha është pjesë e një zgjidhjeje të qëndrueshme është kaq e përparuar. Ky është një moment

i jashtëzakonshëm dhe dua t'ju përgëzoj për kujdesin që keni për vendin tuaj në momentin që planifikoni t'i bëni gjërat ju i bëni me zemër bashkë me ekipin tuaj dhe shpresoj që kjo të funksionojë si motivues për të thënë se shumë po ndodh në Shqipëri, rruga para është shumë entuziazmuese, nuk ju falënderoj dot mjaftueshëm që më besuat dhe nuk do t'ju zhgënjë", është shprehur El

Alabbar.

Projekti për portin e Durrësit u miratua në parlament në fund të vitit të kaluar mes shumë kundërshtimesh nga opozita, e cila e cilëson atë si aferën korruptive më të madhe në 30 vitet e fundit. Projekti është rreth 2 miliardë euro, një pjesë e së cilës do të mblidhen nga shitja e apartamenteve që kanë nisur prej disa javësh.

## Të paktën 37 të vdekur nga një sulm vetëvrasës në një xhami pakistaneze

**Peshawar, 30 janar** - Të paktën 37 besimtarë janë vrarë dhe rreth 150 të tjerë janë plagosur në një sulm që dëshmitarët thanë se ishte një sulm vetëvrasës brenda një xhamie në qytetin veriperëndimor pakistanez të Peshavarit. Dëshmitarët okularë i thanë "Radio Mashaal" se kamikazët që qëndronin në rreshtin e parë pas imamit shpërthyen jelekët me eksplozivë derisa besimtarët, përfshirë shumë policë dhe zyrtarë të tjerë, ishin mbledhur për lutjet e pasdites në Xhaminë e Linjës së Policisë më 30 janar. Dhjetëra të plagosur u transferuan në spitalet përreth, tha një oficer policie. Disa prej tyre ishin në gjendje kritike, tha ai, duke shtuar se numri i të vdekurve mund të rritet. Një zyrtar i spitalit tha se 10 deri në 15 persona janë në gjendje



kritike.

Sipas "Associated Press", të paktën 150 persona ishin duke marrë pjesë në lutje kur ndodhi shpërthimi, megjithëse burime të tjera thanë se numri i

besimtarëve në xhami ishte rreth 260 persona. Askush nuk e ka marrë përgjegjësinë për shpërthimin. Talibanët pakistanezë, të njohur si Tehreek-e-Taliban Pakistan

(TTP), kanë marrë përsipër sulme të ngjashme në të kaluarën. Grupi radikal ka zhvilluar një kryengritje në Pakistan gjatë 15 vjetëve të fundit. Kryeministri Shahbaz Sharif

dënoi sulmin dhe tha se do të ndërmerren "veprime të rrepta" kundër atyre që e kanë kryer atë. Korrespondentët e "Radios Evropa e Lirë" në zonë thanë se xhamia është frekuentuar nga oficerë policie dhe zyrtarë nga qeveria provinciale, zyrtarë të cilëve ndodhen në të njëjtën zonë.

Ish-kryeministri Imran Khan e dënoi gjithashtu shpërthimin, duke e quajtur atë një "sulm vetëvrasës terrorist". "Është e domosdoshme që ta përmirësojmë mbledhjen tonë të inteligjencës [dhe] të pajisim siç duhet forcat tona të policisë për ta luftuar kërcënimin në rritje të terrorizmit", ka shkruar Khan në "Twitter".

Peshavari është kryeqyteti i provincës së paqëndrueshme Khyber Pakhtunkhwa e cila kufizohet me Afganistanin.

## Finlanda shpreson të anëtarësohet në NATO së bashku me Suedinë

**Helsinki, 30 janar** - Finlanda ende shpreson t'i bashkohet NATO-s së bashku me Suedinë, tha më 30 janar ministri i Jashtëm finlandez. Këto deklarata Pekka Haavisto i bëri pavarësisht se presidenti i Turqisë, Rexhep

Tajip Erdogan, tha gjatë fundjavës që shkoi se Ankaraja mund ta pranojë anëtarësimin e Finlandës pa Suedinë. "Dëshira jonë në Finlandë është ende që t'i bashkohemi NATO-s së bashku me Suedinë", tha

Haavisto, duke shtuar se "qëndrimi ynë vazhdon të jetë i njëjtë". Ankaraja ka refuzuar t'i ratifikojë aplikimet e këtyre dy shteteve për në NATO, pikë së pari për shkak të refuzimit të Suedisë që të ekstradojë dhjetëra

të dyshuar që Turqia pretendon se janë të lidhur me luftëtarët kurdë dhe me puçin e dështuar të vitit 2016. Suedia ka diasporë më të madhe kurde sesa Finlanda dhe ka më shumë mospajtime me Ankarën.



## Mustafa dhe Shala: Qeveria Kurti po e zhytë vendin në krizë

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 JANAR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kërkuar shfuqizimin e rivlerësimit për tatimin në pronë dhe ka njoftuar se të martën do ta propozojë amendamentimin e ligjit aktual për tatimin në pronë e paluajtshme.

Koordinatori i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë në PDK, Arben Mustafa, ka thënë se veprimi i fundit i Qeverisë së Kosovës për t'i shtrenjtuar faturat e tatimit në pronë shpërfaq mungesën e konsideratës për vështirësitë me të cilat po ballafaqohen qytetarët e Kosovës si pasojë e krizës

ekonomike. "Qeveria e Kosovës po e zhytë vendin nga kriza në krizë, ndërsa për të gjitha krizat e ka pothuajse përgjigjen e njëjtë, shpërndarjen e 100 eurove që tashmë po paraqet instrumentin më të dalluar të politikëbërjes ekonomike të kësaj qeverie e të cilat në asnjë rast nuk kanë arritur t'i adresojnë nevojat e qytetarëve. Në rastin e tatimit në pronë, kjo mbështetje e propozuar madje nuk ka as bazë ligjore, gjë që krijon evidencë shtesë se kjo qeveri po bën politikë shkel e shko, pa e kuptuar rëndësinë e veprimeve të veta dhe pa një plan serioz se ku dëshiron të arrijë. Ky veprim si dhe veprimet e tjera janë përpjekje për t'i mbuluar

skandalet e njëpasnjëshme e sidomos skandalin rajonal të korrupsionit shumëmilionësh të ambasadorit Martin Berishaj", ka theksuar ai.

PDK-ja kërkon shfuqizimin e menjëhershëm të rivlerësimit mbi tatimin në pronë dhe aplikimin e faturave që kanë qenë në vitin 2022, ndërsa gjatë vitit 2023 kërkohet që të punohet në ligjin e ri të tatimit në pronë i cili duhet t'i adresojë defektet e ligjit aktual", është shprehur Mustafa. Ndërsa deputeti Ferat Shala njoftoi se PDK-ja ka një propozim për amendamentimin e ligjit aktual për tatimin në pronë e paluajtshme, të cilin do ta dorëzojë sot në Kuvendin e Kosovës. "Si grup parlamentar i PDK-së që nga nesër do ta ndërmarrim nismën

i përket zonimit dhe kërkesave të komunave për më tepër fleksibilitet në normat e tatimit në pronë. Prandaj, Partia Demokratike e Kosovës kërkon shfuqizimin e menjëhershëm të këtij rivlerësimi dhe aplikimin e faturave që kanë qenë në vitin 2022, ndërsa gjatë vitit 2023 kërkohet që të punohet në ligjin e ri të tatimit në pronë i cili duhet t'i adresojë defektet e ligjit aktual", është shprehur Mustafa.

Ndërsa deputeti Ferat Shala njoftoi se PDK-ja ka një propozim për amendamentimin e ligjit aktual për tatimin në pronë e paluajtshme, të cilin do ta dorëzojë sot në Kuvendin e Kosovës. "Si grup parlamentar i PDK-së që nga nesër do ta ndërmarrim nismën

ligjore për amendamentimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme", ka theksuar ai.

Deputeti Shala tha se pas miratimit të këtij amendamenti, PDK-ja propozon të hapet një debat për ta rishikuar në detaje këtë ligj. "Ky veprim juridik do të duhet ta përfshinte: Normën tatimore, me mundësinë për ta ulur kufirin e poshtëm të normës tatimore; Zonimin dhe nënzonimin sipas legjislacionit në fuqi; Kriteret dhe metodologjia e vlerësimit të pronave të përcaktohet me ligj. Të gjitha këto duhet të bëhen pasi të miratohet amendamenti i propozuar që lë në fuqi normën tatimore ose lartësinë e tatimit siç ka qenë para rritjes së fundit", ka pohuar Shala.



## Me 80 centë mund të udhëtoni 24 orë me autobusët e Trafikut Urban



PRISHTINË, 30 JANAR - Komuna e Prishtinës, në kuadër të Marrëveshjes së Kredisë në mes të Trafikut Urban Prishtinë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), me qëllim të përmirësimit të shërbimit të transportit publik dhe inkurajimit të qytetarëve për përdorimin e autobusëve, ka riorganizuar planin e tarifimit.

Komuna e Prishtinës ka njoftuar se për të gjithë përdoruesit e rregullt çmimi i biletës mujore nga 14.00 euro do të zbrësë në 13.50 euro. "Në anën tjetër, për t'iu përshtatur nevojave të të gjithë qytetarëve, kemi përfshirë në planin tarifor biletat javore dhe ditore shumëpërdorimëshe: Biletat ditore përfshin udhëtime vajtje-ardhje pa limit përgjatë 24

orëve, me çmimin 0.80 euro. Biletat javore përfshin udhëtime vajtje-ardhje pa limit në të gjitha ditët e javës me çmimin 4.00 euro. Një biletë e rregullt autobusi, e cila mund të përdoret vetëm për një drejtim, do ta ketë çmimin 0.50 euro", ka njoftuar komuna e Prishtinës.

Ky plan i ri tarifor do të aplikohet nga data 31 janar 2023.

## Haxhiu e Gjini flasin për veprimet e përbashkëta institucionale kundër dhunës në familje

Gjakovë, 30 janar - Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, është takuar me kryetarin e komunës së Gjakovës, Ardian

Gjini, me të cilin ka diskutuar për veprimet e përbashkëta institucionale kundër dhunës në familje. "Adresova çështjet që

ndërlidhen me funksionalizimin dhe fuqizimin e mekanizmit koordinues komunal, vazhdimin e

mbështetjes për strehimoren dhe fuqizimin e kapaciteteve të Qendra për Punë Sociale", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".





FRIEDRICH-EBERT-STIFTUNG (FES) PUBLIKON ZYRTARISHT DRAFTSTATUTIN PËR FORMIMIN E ASOCIACIONIT DHE KOMPETENCAT QË DO TË KETË

## Draftstatuti nga FES-i: Asociacioni në përputhje me Kushtetutën, me simbole të veta, kuvend e kryetar

Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), në bashkëpunim me Institutin Evropian për Paqe, kanë publikuar versionin e draftstatutit për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Aty parashihet që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë të formohet në përputhje me Kushtetutën dhe sistemin juridik të Kosovës. I përbërë nga 7 kapituj dhe 18 nene, ky draftstatut parasheh mënyrën e themelimit, strukturën organizative, marrëdhëniet me autoritetet qendrore, rregullimin ligjor, buxhetin, si dhe aspekte të tjera të funksionimit të këtij asociacioni, përfshirë simbolet

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 30 JANAR** - Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), në bashkëpunim me Institutin Evropian për Paqe, kanë publikuar versionin e draftstatutit për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas këtij draftstatuti, Asociacioni do të formohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

I përbërë nga 7 kapituj dhe 18 nene, ky draftstatut parasheh mënyrën e themelimit, strukturën organizative, marrëdhëniet me autoritetet qendrore, rregullimin ligjor, buxhetin, si dhe aspekte të tjera të funksionimit të këtij asociacioni, përfshirë simbolet. Në kapitullin e parë, neni 1, pika 2, thuhet: "Statuti do të miratohet nga kuvendi themelues i

Asociacionit/Bashkësisë i formuar nga anëtarët me votim të kuvendeve komunale të komunave pjesëmarrëse në përputhje me Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Statuti do të miratohet me akt juridik të Qeverisë së Kosovës dhe do të marrë fuqinë e një rregulloreje të Qeverisë sipas sistemit juridik të Kosovës pas shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese".

Ky draftstatut thekson se Asociacioni do të jetë si person juridik i themeluar në përputhje me Kushtetutën dhe sistemin juridik të Kosovës. Më tutje theksohet se Asociacioni/Bashkësia do t'i ketë simbolet e veta zyrtare, duke përfshirë stemën dhe flamurin, të cilat do të dizajnohen nga Bordi i Asociacionit/Bashkësisë në

përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Qeverisje Lokale.

Për krijimin e tij, Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje në vitin 2013 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve që zhvillohet në Bruksel.

Me gjithë trysinë e faktorit ndërkombëtar, Kosova deri më tash nuk e ka zbatuar këtë marrëveshje. Kryeministri Albin Kurti në disa raste ka përsëritur se në Kosovë nuk mund të formohen asociacione njëetnike.

Duke prezantuar draft-statutin, përfaqësuesi i organizatës Friedrich-Ebert-Stiftung në Kosovë, Rene Schlee, tha se gjatë hartimit të tij janë kujdesur që ai të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe me Marrëveshjen e Brukselit. "Ky është një projekt i pragmatizmit politik, sepse ne kemi menduar se do të vijë koha kur do të ishte i nevojshëm statuti i Asociacionit", tha ai.

### Çfarë parasheh draftstatuti?

Sipas këtij dokumenti, Asociacioni parashihet t'i ketë simbolet e veta zyrtare, duke përfshirë stemën dhe flamurin, të cilat do të dizajnohen nga Bordi i Asociacionit në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Statuti do të miratohet nga një kuvend themelues i Asociacionit, i përbërë nga anëtarët e votuar të kuvendeve komunale të komunave pjesëmarrëse.

Statuti do të miratohet me akt juridik të Qeverisë së Kosovës dhe do të hyjë në fuqi pas shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Sipas dokumentit, anëtarë të këtij asociacioni mund të jenë dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë: Mitrovica e Veriut, Klokoti, Parteshi, Ranillugu, Graçanica, Zveçani, Zubin Potoku, Novobërda, Leposaviqi dhe Shtërpca. Anëtarësimi është vullnetar dhe çdo anëtar duhet t'i përmbahet statutit.

Asociacioni, sipas dokumentit të paraqitur, do të ketë të drejta të plota në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, në fushën e edukimit, planifikimit urban, si dhe rural. "Asociacioni ka të drejtë të ketë buxhet të vetin, llogari bankare, prona, si dhe të angazhohet në transaksione financiare", thuhet në draftstatutin e prezantuar nga Friedrich-Ebert-Stiftung.

Një ndër nenet flet edhe për objektivat e Asociacionit, të cilat, siç thuhet, janë: forcimi i demokracisë lokale, duke lehtësuar, financiar ose promovuar aktivitete që avancojnë pjesëmarrjen qytetare

dhe praktikat demokratike, si dhe përfaqësimi i interesave të rëndësishme për demokracinë lokale.

Në draftstatut thuhet se Asociacioni do të ushtrojë edhe kompetenca të tjera shtesë, që mund të delegohen nga autoritetet qendrore, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Sa i takon strukturës organizative, neni 6 parasheh që Asociacioni të ketë: kuvendin e Asociacionit, kryetarin e Asociacionit, nënkryetarin e Asociacionit, këshillin e Asociacionit dhe bordin e Asociacionit.

Neni 15 parasheh që Asociacioni të angazhohet me autoritetet qendrore të Kosovës në shkëmbimin e informacioneve, në frymën e promovimit të demokracisë dhe multietnicitetit, bazuar në sistemin ligjor të Kosovës.

Sa i takon rregullimit ligjor, neni 16 parasheh që Qeveria e Kosovës përmes një akti juridik t'i japë Asociacionit statusin e subjektit juridik. "Kjo përfshin të drejtën e zotërimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme" dhe të "bashkëpronësisë së shoqërive që ofrojnë shërbime lokale brenda fushëveprimit të Asociacionit". Shpenzimet e Asociacionit parashihet të jenë subjekt i auditimeve nga autoritetet

## Policia sekuestron mbi 100 kilogramë marijuanë

PRISHTINË, 30 JANAR - Policia e Kosovës (PK) ka njoftuar se të dielën mbrëma ka sekuestruar 107 kilogramë substancë narkotike të dyshuar të llojit marijuanë. Sipas njoftimit të PK-së, një kamion me targa të huaja, që drejtohej nga shtetasi serb M. P., u ndalua në terminal doganor, ku gjatë kontrollit në dy rezervuarët e derivateve i janë gjetur 101 paketime të plastikës me marijuanë. "Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve, me datë 29.01.2023, në orën 22:40, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, në terminal doganor ka ndaluar një kamion 'Iveco' me targa të huaja të cilin e drejtonte i dyshuari M. P., (1991), shtetas i Serbisë, nën dyshimin për substancë narkotike. Në bashkëpunim me oficerët e Doganës së Kosovës, gjatë kontrollimit në dy rezervuarët e derivateve janë gjetur bunkerë të modifikuar, ku

në brendi kishte 101 paketime të plastikës me substancë narkotike të dyshuar të llojit marijuanë", ka njoftuar Policia e Kosovës, duke shtuar se nga Njësia e Forenzikës është bërë sekuestrimi dhe tërheqja e dëshmive, ku pesha e përgjithshme e narkotikëve të sekuestruar ka qenë rreth 107 kilogramë. "Po ashtu, në cilësi të provave janë sekuestruar edhe një telefon celular, një GPS, disk diagrami i tahogرافit, një kamion, 95 euro si dhe 2 500 dinarë. Në konsultim me prokurorin kujdestar i dyshuari është ndaluar për 48 orë, kurse rasti procedohet për veprime të mëtutjeshme përderisa vazhdojnë veprimet hetimore nga drejtoria përkatëse. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për parandalimin dhe luftimin e të gjitha dukurive të kundërligjshme, në veçanti abuzuesve të substancave narkotike", ka njoftuar Policia e Kosovës.



kompetente, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës. Sa i takon financimit, sipas dokumentit në fjalë, Asociacioni do të financohet nga kontributet e anëtarëve të tij, të ardhurat nga shërbimet e ofruara nga Asociacioni, pasuritë e tij të luajtshme ose të paluajtshme, transferet nga autoritetet qendrore, grantet, donacionet, si dhe mbështetja financiare e shoqatave dhe organizatave të tjera, vendase dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Republikën e Serbisë. Sipas draftstatutit, Asociacioni do të përjashtohet nga detyrimet dhe taksat në arrijen e objektive të tij, në të njëjtën mënyrë sikurse komunat pjesëmarrëse. Qeveria dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës parashihet të kenë qasje në rishikimin e buxhetit vjetor të

Asociacionit përpara se ai të miratohet.

### Rama dhe Çeku në takim me drejtorin e FES-it: LV-ja kundër themelimit të Asociacionit

Sekretari organizativ i Lëvizjes Vetëvendosje, Alim Rama dhe sekretari për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Hajrulla Çeku, kanë pritur të hënën në takim drejtorin e FES-it për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut, Rene Schlee. Në njoftimin për medie të LV-së është bërë me dije se gjatë këtij takimi u vlerësua bashkëpunimi i mirë në mes të LV-së dhe FES-it ndër vite. "U dakordua për bashkëpunim për vitin 2023, me theks të veçantë për fuqizimin e kapaciteteve organizative,

politikën publike dhe qeverisjen lokale. Bashkëpunimi në mes të LV-së dhe Partisë Social Demokratike të Gjermanisë do të jetë një nga objektivat kryesorë gjatë këtij viti në kuadër të rritjes së koordinimit me familjen socialdemokrate në EU dhe në botë. Veç të tjerash, në këtë takim ritheksoam qëndrimin e LV-së kundër themelimit të një asociacioni dhe çdo marrëveshje tjetër mbi baza etnike", ka njoftuar LV-ja. Sipas LV-së, Republika e Kosovës ka një nga sistemet më të mira në botë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë brenda kornizave ligjore/kushtetuese. "Po ashtu, e ftuam FES të bëjë një studim krahasimtar për respektimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë dhe në vendet e tjera,

përfshirë Serbinë", është theksuar në njoftimin e LV-së.

### LDK-ja: Asociacioni, kompetencë dhe përgjegjësi e qeverisë

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka njoftuar se është ftuar nga ambasadori i ShBA-së që të marrë pjesë në takimin e nesërm në të cilin do të diskutohet çështja e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Lidhja Demokratike e Kosovës në këtë takim do ta konfirmojë edhe njëherë mbështetjen për procesin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja me përfshirjen e plotë të ShBA-së. Orientimet e LDK-së për një marrëveshje përfundimtare, ligjrisht të obligueshme, dhe me njohjen reciproke në thelb të saj, mbesin të pandryshueshme", është theksuar në komunikatën e LDK-së.

Më tej thuhet se në lidhje me Asociacionin, LDK-ja vlerëson se kjo çështje është kompetencë dhe përgjegjësi kushtetuese vetëm e institucioneve të Republikës së Kosovës, në radhë të parë e qeverisë. "Kompetencat dhe përgjegjësitë kushtetuese nuk kanë alternativë, prandaj LDK-ja, në rolin e saj opozitar, s'ka se si t'i ushtrojë ato. Opozita nuk mund t'i marrë përgjegjësitë e shumicës dhe as të qeverisë të kësaj shumice. Prandaj pjesëmarrja e institucioneve shtetërore në këtë proces është domosdoshmëri e pazëvendësueshme. LDK-ja i bën thirrje Qeverisë së Kosovës që të mos fshihet prapa akuzave populiste ndaj opozitës, por t'i ushtrojë përgjegjësitë e saj si shumicë dhe ta trajtojë këtë çështje në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës si

dhe në koordinim të ngushtë me aleatët tanë", është thënë në komunikatën e LDK-së.

### Haradinaj: Asociacioni, obligim i marrë që duhet të zbatohet në përputhje me Kushtetutën e Kosovës

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se diskutimet dhe konsultat për Asociacionin kanë vetëm një synim: heqjen e pengesave të fundit drejt marrëveshjes së madhe me Serbinë për njohje të ndërsjellë. "Ky është një obligim i marrë që duhet të zbatohet në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe këtu çështja mbyllet. Prandaj të gjithë ata që Asociacionin e paraqesin si çështje problematike nuk e kanë hallin tek Asociacionin, por duan që Asociacionin ta përdorin si 'mbulesë' për ta kundërshtuar marrëveshjen e madhe. Këtë po e bën Serbia e, fatkeqësisht, këtë po e bën edhe kryeministri i Kosovës", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka theksuar se të gjitha vendimet dhe veprimet e qeverisë në Prishtinë dhe në Beograd, në këta 4-5 muajt e fundit, që nga çështja e targave, tensionet në veri, dalja nga institucionet e serbëve lokalë, e deri te shpallja e zgjedhjeve në veri, kanë qenë obstruksionizëm i planit euro-amerikan. "Kjo lojë politike duhet të marrë fund dhe Kosova duhet t'i fokusojë krejt potencialet politike, intelektuale e qytetare në kryetëmën e saj që është 'marrëveshja e madhe për njohje të ndërsjellë me Serbinë', e cila mund të arrihet vetëm duke qenë të koordinuar ngushtë me ShBA-në dhe BE-në", ka shkruar Haradinaj.



# Kosova drejt federalizimit; njohja reciproke as në qendër e as në thembër!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Zajebnica nuk kalon! Kalon, kalon:** Asociacioni i Komunave të Serbisë në Kosovë ishte kundërshtuar nga të gjithë ata që donin ta ruanin një grusht tokë të mbetur të shqiptarëve dhe të tjerëve e quajtur Kosovë si pjesë e okupuar nga Serbia dhe ish-Jugosllavia, e ndarë dhunshëm nga Shqipëria. Lufta e fundit nuk ishte as zgjedhje e as zgjidhje për shqiptarët sepse në të morën pjesë një përqindje e vogël ndërkaq që e ashtuquajtura politikë paqësore i shndërroi shqiptarët (ata që nuk luftuan dhe nuk e përkrahën luftën) në robër të bindur për ta siguruar një mbijetesë të pajetueshme nën kushte të poshtërimit dhe nënshtrimit të skajshëm. Po të kishte pasur një përkrahje konsensuale politike për luftën dhe po ta merrte përgjegjësinë politike dhe ushtarake udhëheqësi i LDK-së, Ibrahim Rugova, lufta do të merrte përmasa shumë më të mëdha sikur që edhe rezultatet do të ishin më të mira dhe më të qëndrueshme. Erdhi Konferenca e Rambujesë në Paris dhe shqiptarët ishin me fat të madh, jo se e nënshkruan këtë marrëveshje e cila e linte nën Serbi me një marrëveshje ndërkombëtare, por se nuk u nënshkrua nga Slllobodan Millosheviqi që i bëri llogaritë krejtësisht gabimisht. Ky ishte fati ynë që përfituam nga një luftë e jashtëzakonshme e të Madhërishtes Ushtri Çlirimtare e Kosovës dhe nga gabimi amator i

Slllobodan Millosheviqit. Raporti i forcave midis atyre që kontribuuan në çlirim dhe atyre që përfituan nga çlirimi i vendit, luftën e së cilës e penguan me të gjitha mjetet e mundshme, u rikthye pas përfundimit të luftës; partitë penguese i fituan zgjedhjet që nuk ka ndodhur më parë në asnjë vend ku kishte pasur luftë për çlirim. Ecja drejt pavarësisë së mbikëqyrtur (ende kjo pavarësi mbikëqyrtet përmes Rezolutës 1244) kushtëzohej nga ndërkombëtarët që shtronin çështje dhe kushte që shkonin në interes të Serbisë duke e shndërruar në faktor vendimmarrës për çështje që janë 100 për qind përgjegjësi e shtetit, duke ia mbajtur integritetin territorial varur në një teh thike sikur që pengonin shtrirjen e sovranitetit brenda këtij integriteti territorial që e pranuan mbi 100 shtete dhe vende të botës. Realisht, në të gjitha qeveritë e pasluftës, ish-bashkëpunëtorët e Jugosllavisë dhe Serbisë u sistemuan më mirë se më parë duke shtrirë ndikimin në të gjitha fushat, nga ajo më e ndjeshmja - siguria, sistemi gjyqësor dhe prokurorial, mediet elektronike dhe të shkruara, diplomacia dhe në sferat e tjera. Kur Kosova u shpall dhe u njoh si shtet i pavarur dhe sovran, kishte një pavarësi të mbikëqyrtur dhe të kushtëzuar që në planin afatgjatë krijoi dhe legalizoi sistemin paralel të Serbisë

në Kosovë përmes instrumentalizimit të serbëve lokalë. Çdo proces në Kosovë kushtëzohej me lëshime sikur që ishte plani i kriminelit juridik Marti Ahtisari pas të cilit doli propozimi për një Ahtisari Plus (kriminel juridik me yll). U krijuan zonat e mbrojtura, decentralizimi u bë sipas kriterëve ekskluzivisht etnike duke krijuar ishuj dhe hapësira vetëm për serbët, Kisha Ortodokse serbe ishte mbi shtetin dhe nuk u nënshtronte ligjeve të Kosovës. U institucionalizua sistemi paralel në arsim ku mësohej sipas kurikulave të Serbisë, sistemi shëndetësor, ai gjyqësor, u krijua policia paralele, me ndihmën e OSBE-së, Serbia organizonte zgjedhje lokale dhe të përgjithshme në Kosovë. Serbët, sidomos ata që kishin përgjegjësi për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në Kosovë, nuk ndiqeshin apo së voni po ndiqet niveli më i ulët thuaja simbolikisht, ndërsa planifikuesit dhe urdhërdhënësit në bazë të përgjegjësisë komanduese politike, policore dhe ushtarake nuk po ndiqnin, madje ishin liuruar nën presion politik të Serbisë dhe ndërkombëtarëve. Krimineli juridik Marti Ahtisari, përveç shumë lëshimeve që e bëjnë Kosovën shtet gjysmëfunktional, kishte paraparë të formohej një Asociacion i Komunave të Serbisë në Kosovë e që nga IV-ja në atë kohë quhej Zajebnica e që unë e kam

pagëzuar me Zajebnica (Koçeluajtje) që duket se kam qenë shumë i saktë në emërtim. Kjo marrëveshje ishte arritur në Bruksel në vitin 2013 nga ata që nuk shihnin më larg dhe nuk kuptonin rreziqet nga ky mekanizëm parashtetëror. Pastaj, Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjeti se Zajebnica, përkatësisht kjo Marrëveshje, është në kundërshtim, së paku në 22 pika me Kushtetutën e Kosovës, aq herë sa e therën me thikë Bruti dhe Kasi Cezarin gjatë atentatit ndaj tij. Mirëpo, arsytimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kishte të theksuar një biseksualitet juridik për faktin se, edhe flitej për shkelje të Kushtetutës së Kosovës, edhe thuhej se duhet të vazhdohet me themelimin e Zajebnicës. Natyrisht se ky vendim ishte shkruar nga ndërkombëtarët sepse këta kanë kapacitet të shkruajnë vendime dhe raporte me dy apo me më shumë kuptime për t'i kënaqur të gjitha palët ku askush nuk është humbës dhe të gjithë fitojnë, Kosova më së shumti; të trashët e Surles!

**Nuk është më vetëm Zajebnica, tash është autonomia për serbët e veriut dhe shajzen propozimi franko-gjerman:** Gjatë luftës në Ukrainë Kosova ka mbetur thuaja pa bartës të institucioneve, presidentja e Kosovës u bë presidente e Donbasit nga komandon luftën kundër

Wagnerit dhe Putinit. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u bë i deleguar i Zelenskit për Guberninë e Luhanskit, kurse me Kosovën po merret kur këtu gostitë dy mashtrues ordinerë, Lajçakun e Sllovakisë dhe Rrahman Morinën e Katalonjës, Borrellin. Tash numri i mysafirëve është shtuar me amerikanët Chollet që nuk po e lë as frymë të marrë lirisht dhe amerikanin tjetër me mbiemër frikësues dhe të tmerrshëm që po këmbëngulin në formimin urgjent të Zajebnicës dhe pranimin e propozimit bulshit franko-gjerman. Fillimisht thoshin se plani franko-gjerman parasheh njohje reciproke në qendër, ndërsa nga draftet që kanë qarkulluar në opinion del se jo që nuk ka njohje reciproke në qendër, por se nuk ka njohje reciproke as në thembër... të Akilit. Sikur që nuk ka garanci që 5 shtetet mosnjohëse do ta njohin Kosovën apo që Kosova do të bëhet anëtare e Kombeve të Bashkuara (së paku jo sa Rusia të ketë të drejtën e vetos në Këshill të Sigurimit të KB-së). Në këtë propozim nuk ka asgjë dhe, nëse drafti që po qarkullon në opinion është i saktë apo përfaqësisht i saktë, asnjëra nga 10 pikat nuk është e favorshme për Kosovën, asnjëra nga pikat nuk garanton asgjë dhe të gjitha pikat janë të favorshme për Serbinë. Prandaj edhe Vuçiqi e ka pranuar këtë propozim ndonëse sikur hezitonte (për të rritur çmimin) dhe nuk e

bëri gabimin që e bëri Millosheviqi me mosnënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë. Kryeministri Kurti thoshte se marrëveshja është bazë e mirë për bisedime dhe problemi qenka te Serbia që nuk e ka pranuar këtë propozim! Çfarë shkurtpamësie, në vend se të merret me Kosovën, e qanë hallin pse Serbia nuk po e pranon këtë propozim! Kjo marrëveshje eventuale, pjellë e propozimit franko-gjerman që tash po cilësohet si propozim evropian, ndonëse 5 shtete të Kosovës po refuzojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës e që e paska përkrahjen amerikane, do të mund të diskutohej vetëm nëse shtetet iniciuese ofrojnë garanci me shkrim se ajo për të cilën pajtohen palët domosdodhmërisht duhet të zbatohet duke e reduktuar kohën e zbatimit në maksimum 3-5 vjet. Njohja reciproke as që do të duhej të diskutohej, as në qendër e as në thembër. Pa njohje nuk ka asgjë që do të dukej serioze dhe që do ta garantonte zbatimin e marrëveshjes. Modeli i dy gjermanive nuk shkon me asgjë me rastin e Serbisë dhe të Kosovës për faktin se dy gjermanitë kishin 100 % interesa që i bashkojnë, një popull dhunshëm i ndarë, një territor dhunshëm i ndarë, një gjuhë, një besim dhe një religjion, një histori, një kulturë dhe të gjitha të tjerat që i bashkon. Modeli i dy gjermanive do të mund të zbatohet vetëm në rastin midis Shqipërisë dhe Kosovës, si periudhë kalimtare rreth një bashkimi të natyrshëm dhe të pashmangshëm në të ardhmen.

**Antiamerikanizmi apo proamerikanizmi, virtyt apo shprehje e servilizmit:** Pjella biologjike dhe politike e rrogëtarëve të Jugosllavisë dhe të Serbisë e që flisnin shqip, që sot janë sistemuar duke bërë shtatë palë qejfe në qeverinë Kurti 2 sikur edhe në qeveritë paraprake, kur donin të

na sulmonin politikisht dhe kombëtarisht na cilësonin si nacionalistë dhe irredentistë shqiptarë si dhe prishës të kumbarisë me serbët përkatësisht si rrënues të vëllazërim-bashkimit (multietnicitetit asimetrik dhe nënshtrues). Sot, nëse dikush nuk pajtohet me një propozim apo vendim, cilësohet si antiamerikan e që është arma më e fuqishme apo më efikase për eliminim politik. Kjo histori zgjatë që nga koha e Rambujesë. Është forcuar gjatë bisedimeve në Vjenë, gjatë sundimit të kriminelit juridik Marti Ahtisari, gjatë votimit për demarkacion të Kufirit me Maqedoninë e Veriut të Kosovës, Malit të Zi e tash është sforcuar me rastin e Zajebnicës dhe propozimit bullshit franko-gjerman. Janë krijuar dy pole kundërshtuese, pushkatuesit dhe të pushkatuarit, pavarësisht prej bindjeve politike dhe të tjera. Edhe nëse nuk jeni anëtar militant i sektit politik të LV-së, do të cilësoheni si antiamerikan. Çfarë idiotizmi! Kosova me propozimin franko-gjerman, nëse është versioni i saktë ai që po qarkullon në opinion dhe me Zajebnicën, me propozim të komunistëve të FES-it, e ka vetëm një ardhmëri në të ardhmen, të bëhet pjesë e federatës apo konfederatës me Serbinë, asgjë tjetër. Garancitë orale (gojore), qoftë edhe më profesionale të mundshme, nuk sigurojnë tjetër status për Kosovën. Me të gjitha propozimet e deritashme po bëhet përpjekje që të ruhet një lidhje midis Serbisë dhe Kosovës ku Serbia do të ishte përcaktuese për shumë vendime dhe procese, edhe sa i përket Kosovës. Realisht, as Zajebnicën e as propozimin franko-gjerman në këtë formë dhe me këtë përmbajtje kurrë nuk do ta nënshkruaja sepse, po ta nënshkruaja nënkupton se do ta nënshkruaja një union në të ardhmen me Serbinë. Opozita dhe me nder me thënë shoqëria civile

po gabojnë rëndë duke e cilësuar Albin Kurtin si antiamerikan kurse, veten e tyre, pa asnjë kriter njerëzor dhe moral, që ma parë dhe deri në vdekje (politike) e cilësojnë si proamerikanë, madje më të bindur se Xhorxh Washingtoni apo Teodor Ruzvelti. Albin Kurtin, opozita dhe me nder me thënë shoqëria civile kanë njëqindmijë mundësi ta luftojnë Albin Kurtin për lëshime të shumta si mungesa e transparencës (e ka ngjallur ligjin mafioz të Omertës - mbylles së gojës) thuaja për të gjitha proceset e rëndësishme jetike për Kosovën. E ka varfëruar ekonominë e shumicës së familjeve në Kosovë duke ua humbur çdo shpresë për të ardhmen. I ka kapur thuaja të gjitha institucionet duke e legalizuar dhe shndërruar në art punësimet në baza familjare dhe partiake. E ka një qeveri ku gara bëhet jo për ministrin më të mirë, por se cili është më i keq në mesin e të këqijve. Si qeveri e majtë e deklaruar, por jo edhe nga mënyra e jetesës, ka rritur taksat deri në 400 për qind nga një ministër, diferencues i UÇK-së për të ofruar lëshime në formë të faljes prej 100 eurosh. Pensionistët i ka prurë në situatë që e lakmojnë vdekjen, si zëvendësim të një jete të pajtueshme dhe poshtëruese. Skamnorët i ka shndërruar në lypsarë dhe frekuentues të kantave për mbeturina. Nuk po gjen asnjë ekspert të fushës, prandaj po detyrohet t'i riciklojë mbetjet mortore politike si puna e ministrit të Shëndetësisë. E ka shndërruar diplomacinë në një buqkurish që udhëhiqet nga një e padijshme dhe e mbushur plot urrejtje ndaj UÇK-së, ish-të burgosurve politikë dhe Bacës Adem Demaçi. Dhe shumë e shumë të tjera me të cilat nuk po merret opozita. Madje, në një vend që ka vlera kombëtare dhe respekt për ata që kontribuuan për këtë liri, ashtu si është, pas arsytimit kriminal të Albin Kurtit për Oliver Ivanoviqin,

po të ishte në Kosovë, do të detyrohej të largohej nga Kosova, kurse po të ishte jashtë Kosovës, nuk do të lejohej të kthehej në Kosovë. E çka ndodhi pas kësaj? Të bindurit ndaj Mesisë së tyre jo që nuk e gjykuan arsytimin kriminal të Albin Kurtit që e fali kriminelin Oliver Ivanoviq, por shkuan përtej këtij kriminalizimi duke deklaruar se Vuçiqi e ka vrarë Ivanoviqin sepse nuk i është bindur thuaja se Ivanoviqi është dënuar për këtë e jo për vrasjen e, së paku, 40 shqiptarëve. Të njëjtët, përkundër brohoritjeve se Zajebnica nuk kalon, pasi të kalojë, do të gjejnë arsytim duke sulmuar të tjerët. Njëjtë do të veprojnë edhe për propozimin franko-gjerman. Cilësimi i Albin Kurtit si antiamerikan nuk e dëmton aspak politikisht atë sikur që nuk e forcon aspak opozitën. Nëse Albin Kurti, në momentin e fundit, bëhet proamerikan duke pranuar çdo gjë e që lehtësisht mund të ndodhë edhe opozita do të pranojë çdo gjë, pa asnjë dyshim. Ndërkaq, opozita nuk ka asnjë detyrim t'i bëjë votat për Zajebnicën apo propozimin franko-gjerman e as Kodin Civil, nëse mendon se janë të dëmshme për Kosovën. Në takimin në Ambasadën Amerikane për Zajebnicën janë ftuar politikanët që paraprakisht kanë pranuar këtë që Albin Kurti po e refuzon (nëse e refuzon) si dhe me nder me thënë shoqëria civile që nuk ka asnjë ndikim dhe që pjesa e madhe e tyre nuk e kanë lëvizur asnjë gur për Kosovën dhe lirinë e saj. Vetëm kanë përfituar dhe po përfitojnë nga kjo liri. Këta, pa asnjë dyshim, do ta pranojnë çdo propozim, nga Brukseli, Uashingtoni, Beogradi apo Nishi, si propozim gjeografik, propozim politik dhe si bindje, të trashëguar dhe të tashme. Këta nuk përbëjnë asnjë zgjidhje dhe Kosova për një numër të tyre ka kuptimin e xhirrologarisë, asgjë më shumë! Vendimet politike janë përgjegjësi e institucioneve

përkatëse dhe të qeverisë. Sot asnjë vendim nuk mund të merret pa kryeministrin Kurti shkaku i votave që i ka. Albin Kurti nuk qenka në listën e të ftuarve të Ambasadës Amerikane, duket as opossumi politik Besnik Bislimi, ndërkaq janë ftuar Emi Redzepi, zëvendëskryeministër, Nenad Rashiçi, ministër i cilësuar si serb i Kurtit dhe ajo që me këmbëngulje e luan rolin e Ministres për Punë të Jashtme dhe Baushtellë, Donikë Katran (Shvarc) Gërvalla që në çdo paraqitje shkruan epitaf për Zajebnicën, si përkujtim për vdekjen e saj. Rashiçin nuk e pyet askush, as shitësi në trafikën në Laplje Sello sikur as Emi Redzëpin. Ftesa për kumtuesen e vdekjes së Zajebnicës është një kërcënim ndaj Albin Kurtit për të shkaktuar çarje midis koalicionit të dy partive që kanë marrë vota thuaja të njëjta, LV-së me Albin Kurtin dhe luajtësin me gogla që vonë e mora vesh se quhet lojë e tenisit, Glauk Konjufca dhe Listës S'GUXO. Kjo çarje eventuale për Kosovën do ta kishte efektin e Titanikut, do të mbijetonin vetëm ata që kanë pasur fatin të largohen nga Kosova dhe ata që ndërkohë, duke mos zgjedhur mjete dhe rrugë, duan të largohen nga Kosova. Për këtë edhe nuk ka reagim të fuqishëm apo aktivizëm qytetar sepse askush nuk e lidh më fatin për Kosovën, përveç politikanëve dhe varreve! Në Kosovë nuk ka zgjedhje të parakohshme. Albin Kurti për së gjalli nuk dorëhiqet dhe pa Albinin nuk mund të realizohet asnjë marrëveshje, as Zajebnica e as propozimi franko-gjerman. Po Albini është djalë i mirë, i kthyeshëm dhe nuk mund ta paramendojë jetën pa Miroslav Lajçakun, rrencin dhe mashtruesin nga Sllovakia dhe pa gjyshin Josep Borrell apo Rrahman Morinën e Katalonjës. Prandaj, hiqeni nga rendi i ditës antiamerikanizmin e Albin Kurtit!



# Ekonomistët thonë se mosstabiliteti politik në Kosovë paraqet problem për investimet e huaja

PRISHTINË, 30 JANAR - Projektligji për Investime të Qëndrueshme ka për qëllim ta rregullojë promovimin, përkrahjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve të qëndrueshme në Kosovë.

Përfaqësues të Odës Ekonomike të Kosovës vlerësojnë se ky ligj do të jetë i dobishëm për investime të huaja në Kosovë përderisa njohës të ekonomisë bëjnë thirrje për sundim të ligjit dhe stabilitet politik.

Projektligji për investime të qëndrueshme synon nxitjen e zhvillimit ekonomik, duke e orientuar në prodhim dhe eksport.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulëzim Rafuna, ka thënë se ky ligj ka një qartësim të procedurave dhe të fushave ku Kosova mendon që janë investime strategjike për të bërë biznes në Kosovë. "Mundësitë tani janë më të mëdha për t'i ndihmuar investimet e huaja dhe ne kemi nevojë shumë për investime të huaja dhe kualitative në Kosovë e që krijojnë vende pune dhe që krijojnë zhvillim ekonomik të Kosovës. Ka qenë

kërkesë e kohës dhe është shumë mirë që Ligji për Investime të Qëndrueshme dhe ritheksoj se, përveç objektivave dhe fushave, është qartësuar edhe mënyra se çka përfitojnë bizneset, është paraparë cilat do të jenë lirimet, mundësitë që ofron shteti në dhënien e pronës publike për investime dhe pres që edhe gjatë fazave në Kuvendin e Kosovës të përgatitet dhe të bëhet një ligj i mirë për tërheqjen e investimeve të huaja në Kosovë", ka thënë Rafuna. Njohësi i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka thënë se Kosova nuk ka problem me mungesë të ligjeve, por ka nevojë për zbatim dhe implementim të tyre.

Duke folur për "Radio Kosovën", ai thotë se emërues i përbashkët i gjithë këtyre pasojave ekonomike është mosstabiliteti politik. "Pa stabilitet politik nuk besoj që edhe ky ligj do ta ketë efektin e vet, prandaj besoj se duhet të jemi në aktivë në dialog, në partneritet për zgjidhjen e problemit apo arritjen e një ujdje ndërmjet Kosovës dhe



Serbisë, dhe derisa Kosova do ta ketë këtë litar dhe nuk do të jetë i zgjidhur, ne do të flasim për investime të huaja, por ato nuk do të jenë në Kosovë. Prandaj ligji e ka efektin e vet nëse do të kemi stabilitet ekonomik dhe sundim të ligjit, ndërsa do të ketë efekt të keq, nëse këto dy shtylla lënë hapësirë për të dëshiruar, por

nëse nuk do të arrihet stabilitet politik, mos të mendohet se do të kemi brende prestigjioze ndërkombëtare të cilat me praninë e tyre në Kosovë, përveç rëndësisë ekonomike, do ta kishim edhe aspektin social", është shprehur Gërxhaliu. Projektligji për investime të qëndrueshme do t'i zëvendësojë Ligjin për

Investime Strategjike dhe Ligjin për Investimet e Huaja.

Ndër të tjera, projektligji parasheh të drejtat dhe detyrimet e investitorëve, shpalljen dhe zbatimin e projekteve të investimit strategjik, eksportet si dhe kompetencat për përkrahje dhe zhvillimin e ndërmarrjeve në Kosovë.

## Bordi i AKP-së njoftohet me përgatitjen e N. Sh. "Brezovica" për sezonin dimëror



PRISHTINË, 30 JANAR - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën ka diskutuar dhe ka marrë një numër vendimesh të rëndësishme.

Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar raportin mujor të menaxhmentit për periudhën paraprake, raportin mujor për N.Sh. "Brezovica" nën administrim të drejtpërdrejtë lidhur me përgatitjet e N. Sh. "Brezovica" për sezonin dimëror si dhe u azhurnua lidhur me zhvillimet gjatë kësaj periudhe.

Bordi, gjithashtu, ka diskutuar për listën e aseteve për SHAL 62 dhe ka kërkuar që komunave t'u jepet kohë shtesë për shprehjen

eventuale të interesit për shpronësim të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore.

Në këtë mbledhje Bordi i Drejtorëve shqyrtoi dhe aprovoi raportin e Komisionit të Banësive me rekomandime për të bënë banesa pronë të ish-NSh-ve.

Veç kësaj, Bordi, gjithashtu, shqyrtoi rezultatet e çmimeve të ofertimit nga qiradhënia e aseteve (likuidim) përmes shpalljes publike të datës 21/12/2022 për 36 asete.

Gjatë kësaj mbledhje Bordi shqyrtoi propozimet e Autoritetit të Likuidimit për raportet e shpërndarjes për kreditorë dhe aprovoi shpërndarjen për Ndërmarrjen PRN022 N. Sh. "Fabrika e Letrës, Ambalazhit dhe Kartuçit".

## ATK-ja vendos disa kufizime në EDI për deklarimet në librat e Shitjes dhe të Blerjes

PRISHTINË, 30 JANAR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) njofton se nga 1 shkurti do t'i publikojë ndryshimet në kuadër të Sistemit Elektronik (EDI).

Ndryshimi që do të jetë në krahasim me versionin e tanishëm është kufizimi në deklarimin e Librit të Blerjes dhe Librit të Shitjes të cilat

nuk do të mund të dërgohen nëse nuk janë të plotësuar ashtu siç kërkohet.

Më konkretisht, ATK-ja thotë se kufizimet janë bërë në kolonën e Numrit Unik Identifikues, Numrit Fiskal dhe Numrit Personal.

Libri i Blerjes dhe Libri i Shitjes duhet të plotësohen dhe të deklarohen në baza

mujore nga data 1 deri më 20 të muajit vijues, pra librat kërkohet të deklarohen në periudhën kur dorëzohet edhe Deklarata e TVSh-së.

Sa i përket plotësimit të Librit të Blerjes dhe Librit të Shitjes, referojuni udhëzuesve përkatës të publikuar në uebfaqen e ATK-së te linku Shërbime Elektronike - Libri i Blerjes dhe i Shitjes.





# Arbëreshët dhe hebrenjtë

## Hebrenjtë nuk ishin pushtues, vetëm me pushtuesit shqiptari është i egër!

Për shqiptarët hebrenjtë nuk ishin "të huaj", ata ishin "Mysafir" sipas ligjit të vjetër tëshqiptarit ku: Shtëpia është e Zotit dhe e mikut! Jo më tepër se rreth 7 km kilometra prej Mongrassano-Cervicati, si dhe jo larg nga Spezzano Albanese, në mesin e katundeve arbëreshe në Kalabri, gjendej një kamp përqëndrimi, Ferramonti me 4000 vende, më i madhi nga 15 kampet e përqëndrimit për hebrenjtë e ndërtuar sipas ligjeve raciale të vitit 1938 në Itali prej Musolinit.

«Hebrenjtë te cilët vinin nga e gjithë Evropa, ajka e shkencës dhe inteligjencës hebraike»- kujton shkrimtari dhe fotografi hebre dalmat, Luciano Morpurgo në librin e tij tësuksesshëm "Caccia all'uomo" i botuar në vitin 1946- ishte përqëndruar në një duzinë baraka të mëdha prej druri, ndërtuar për bonifikimin" nga fashizmi në vitin 1940.

Brenda këtij kampi, ndryshe nga kampet e tjera, ku trenat i përcillnin hebrenjtë drejt vdekjes, ata që zbritën nga ky tren ishin disi më me fat, sepse drejtimi i këtij treni nuk mbarti stacionin drejt furrave të djegies, por të shpëtimit.

Ndërtesa e Kampit prej vitit 2004 është kthyer në Muze.

Këta hebrenjë që u sistemuan në kampin e Ferramonti u mirëpritën nga populli arbëresh dhe kalabrez. Hebrenjëve të dëbuar dhe të internuarve, në këtë kamp iu lejua, liri dalje, Ata ngritën një infermieri me një farmaci të aneksuar ku Mjekëve hebrenj iu lejuan të praktikonin profesionin e tyre. Shpesh banorët e zonës përreth kampit vinin dhe kuroheshin tek ata.

Kampi u kthye dhe si strukturë mësimi dhe edukimi. Ata ngritën një shkollë, një kopsht, një mensë për fëmijë, një bibliotekë, një teatër dhe objekte kulturi (dy sinagoga, një kishë katolike dhe një tjetër ortodokse greke ).

Bashkimet dhe martesat mes të internuarve dhe banorëve nuk ishin të rralla. Gjatë asaj periudhe u lindën 21 fëmijë.


Në bibliotekën Masci, \Mashi në Santa Sofia të Epirit, (edhe ky një katund arbëresh), ruhet në brëndësinë të saj një pikturë, e cila nuk është thjeshtë një skicë, por përmban brënda saj një botë, shpirtra, e jetë njerëzish. Mbi këtë skicë është evidencuar fjala Falenderim " Ringraziamento". E gjithë përmbajtja i përkushtohet një familje arbëreshe, Familja Cardamone nga Santa Sofia.

Skica i ngjan një diplome nderi, e pikturuar me bojëra uji. Në të majtë të fletës, është një udhëtar me një mushkë që përshkon kodrat në një shtëpi. Përshkohet jeta e përditshme e tyre, Giovanni Cardamone dhe familjes se tij që i shpetoi jeten ketij hebreu, e mbajti në shtëpi deri në momentin e largimit të tij. Ajo që i bashkon hebrenjtë dhe shqiptarët është dashuria për vendin, malli për atdhe e për sakrificë ndaj idealeve për atdhedashuri!

Një sërë personalitete të jashtëzakonshme gjetën strehë në kampin Ferramonti. Mund të përmendim:

Ernst Bernhard, mjek dhe psikiatër nga Berlioni, i cili ishte një nxënës i rëndësishëm i Carl Gustav Jung në Cyrih, analist i personaliteteve të mëdha të kulturës italiane, me të cilët u bë mik dhe i besuar, si Federico Fellini, Natalia Ginzburg, Giorgio Manganelli dhe Cristina Campo; Imi Lichtenfeld, hebre hungarez, asokohe shtetas izraelit, i cili hyri në histori si ekspert i arteve marcial dhe shpikës i metodës së famshme luftarake dhe vetëmbrojtëse të quajtur Krav Maga, e praktikuar sot nga agjentët e Mossad-it dhe trupat e zgjedhura izraelite;

Moris Ergas, një hebre grek që pas çlirimit u bë një nga producentët më të rëndësishëm të filmit të



kinematografisë italiane në vitet 1960, duke e lidhur emrin e tij me atë të kryeveprave të Rosselinit, Pasolini dhe De Sica;

David Mel, i cili punoi si kuzhinier gjatë ndalimit të tij në Ferramonti, por më vonë u bë një shkencëtar i cili u nominua disa herë për çmimin Nobel për mjekësi, zbuluesi i vaksinës për dizenterinë; Richard Dattner, një hebre i ri polak i internuar me familjen e tij në Ferramonti, i cili emigroi në SHBA dhe u bë një nga arkitektët më të rëndësishëm dhe më të famshëm amerikanë pas luftës;

Oscar Klein, një hebre i ri austriak i burgosur me familjen e tij në Ferramonti, ku me sa duket mësoi bazat e xhazit, dhe i cili më vonë u bë një kompozitor dhe interpretues ifamshëm i muzikës sëing dhe Dixieland;

Menachem Shelah, një ebre dalmat i cili më vonë emigroi në Izrael ku u bë një historian dhe studiues i rëndësishëm i Shoas; Michel Fingesten, një hebre italo-austriak që studioi në Vjenë së bashku me mikun e tij Oskar Kokoschka, duke u bërë nga ana

tjetër një nga artistët dhe gdhendësit më të rëndësishëm të shekullit të shkuar, i famshëm për ish-libris për veprat e tij grafike të ekspozuara në muzetë në mbarë botën. - i internuar në Ferramonti, ngriti një shkollë arti për të burgosurit e kampit. Fatkeqësisht, Fingesten vdiq disa ditë pas lirim të tij për shkak të një infeksioni të marrë në robëri. Ai prehet në varrezat e vogla të Cerisanos, pranë Kozencës.

Gustav Brenner, një hebre austriak, i cili e shndërroi vuajtjen dhe heqjen e lirisë në Ferramonti në një zgjedhje jete që e çoi atë të vendosej në Cozenza, ku pas luftës ai themeloi një botim. Shtëpia e kulturës e specializuar për vepra të lashta dhe të rralla të ribotuara në botime anastatike është aktive edhe sot.

### Shqiptarët dhe Hebrenjtë

Kur fqinjët tanë si Bullgaria, e cila aplikoi ligjin antisemit, apo Serbia që ishte rajoni i parë evropian ku Holokausti u zbatua në mënyrë radikale, sistematike dhe të plotë, në Shqipëri për arsye të forta e të brëndëshme nuk u lejua aplikimi i këtij ligji .

Senatori amerikan me origjinë arbëreshe, Joesef Dioguardi së bashku me kongresmenin Tom Lantos, hebre/hungarez, i mbijetuar i Holokaustit, në një vizitë në Shqipëri në vitin 1990, duke ditur mbi rolin e shkëlqyer të shqiptarëve mbi hebrenjtë, nëpërmjet një leje të posaçme nga Ramiz Alia, kërkuan të bënin hulumtime e kërkime në arkivën e shtetit mbi aktet për konstatimin e shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri.

Dokumentet u nisën për në Izrael të cilat u ekzaminuan nga Yad Vashem i cili i konsideroi të vlefshme dhe ato ishin një minierë mbi shpëtimin e hebrenjëve nga shqiptarët e Mitrovicës, Preizërenit, Pejës, Deçanit, Gjakovës, Fierit,

Gjirokastrës, Shkodrës, Tiranës, Elbasanit, Burrelit, Korçës, Delvinës etj .

Nga aktet mësojmë midis të tjersh se një regjiment prej katër burrash të udhëhequr nga Mehdi Frashëri në atë kohë Kryeministër; iu kërkua lista e hebrenjve që banonin në Shqipëri, por qeveria nuk pranoi, dhe përkundrazi i ndihmoi hebrenjtë duke i furnizuar me dokumente false, pashaporta dhe duke i bërë ata të ndiheshin qytetar të barabart sishqiptar. Në ato vite asnjë ligj zyrtar nuk u mor për ta si për dorëzimin e tyre ashtu edhe për vjedhjen e pasurisë së tyre.

### Deshmia e Irene Grunbaum, e cila gjithashtu shpëtoi nga vdekja

Në librin "Autobiografia" e Irene Grunbaum, përkthyer dhe redaktuar nga Katherine Morris lexohet:

Lamtumirë Shqipëri. Më ke dhënë aq shumë, mikpritje, strehim, miq dhe aventura. Lamtumirë shqiptarë, një ditë do t'i tregoj botës se sa të mirë janë, pa frikë, të fortë dhe besnikë bijtë tuaj, sa vdekja dhe djalli nuk mund t'i frikësojnë ata. Nëse është e nevojshme, ata do humbasin dhe jetën e tyre për tju mbrojtur ju. Portat e vendit tuaj të vogël mbetën të hapura, Shqipëri. Sytë e tu mbyllen kur është e nevojshme me mosbindje, kur është për t'u dhënë njerëzve të persekutuar të mbijetuar në një ngaluftërat më të tmerrshme.

Shqipëri, ne mbijetuan për shkak të humanizmit tuaj. Ju falënderojmë.

**Omela RADOVICKA**

Qendra albanologjike, pranë Bibliotekës A. Bellusci

Frasnito\Frascineto \ Calabri



(fotografia Biblioteca Masci)

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Tri sfida interesante në Ligën Unike

**PRISHTINË, 30 JANAR** - Mesjava sjell ndeshjet e xhiros së tetë në Ligën Unike të Femrave, ku priten përballje interesante me skuadrat që duan të jenë pjesë e Top 4 dhe të garojnë për titullin e kampionit. Takimi i parë do të jetë ndërmjet Bashkimit dhe Penzës, një derbi kosovar në Ligën Unike. Vashat prizrenase kanë katër fitore e tri humbje, ndërsa ato pejane numërojnë dy fitore e pesë humbje, ku

momentalisht janë në vendin e fundit në tabelë. Flamurtari do të përballlet me skuadrën tjetër shqiptare, Tiranën. Vashat vlonjate janë lidere me gjashtë fitore e një humbje, ndërsa tiranaset kanë dy fitore e pesë humbje. Ndeshja e fundit është ndërmjet skuadrave kryeqytetase, Partizanit të Tiranës dhe Prishtinës. Partizani numëron katër fitore e tri humbje, ndërsa skuadra

prishtinasit ka tri fitore e katër humbje, andaj pritet një sfidë interesante në Tiranë.

**LIGA UNIKE E FEMRAVE  
- JAVA 8**

**Të martën takohen:  
17:00 Bashkimi - Penza  
Të mërkurën takohen:  
19:00 Flamurtari - Tirana  
17:00 Partizani - Prishtina**



## Nga edicioni i ri nis Liga U21

**PRISHTINË, 30 JANAR** - Duke filluar nga edicioni i ri 2023/24 në futbollin e Kosovës do t'i nisë garat edhe Liga U21. KE i FFK-së, në mbledhjen e fundit, ka marrë vendim për organizimin e kësaj lige, kurse pjesë e saj do të jenë ekipet e Superligës. Qëllimi i kësaj lige është që futbollistëve të kësaj moshe, të cilat po hasin vështirësi të gjejnë hapësirë në ekipin e parë, t'u jepet mundësia të qëndrojnë në formë, të zhvillohen dhe t'i tregojnë vlerat e tyre në vazhdimësi, në mënyrë që të përgatiten për të qenë pjesë e ekipit të parë. "Përvoja e hershme profesionale është çelësi për të pasur sukses në futboll, prandaj edhe ekzistimi i Ligës U21 do të jetë i mirëseardhur për futbollistët nën moshën 21-vjeçare, ngaqë përqindja e minutave të luajtura nga ana e tyre në Albi Mall Superligë



është kryesisht e vogël", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit. FFK-ja do t'ua mundësojë ekipeve

që në këtë ligë të përfshijnë edhe dy futbollistë deri në moshën U23, të cilët, për shkaqe të ndryshme, (si

rikuperimi nga lëndimet apo rënia e formës) qëndrojnë larg skuadrës së parë. Ndërkaq, të drejtë loje do të

kenë edhe lojtarët më të rinj sesa U21, nëse një gjë të tillë e shohin të arsyeshme klubet. Më herët KE i FFK-së kishte vendosur që nëse klubet janë të interesuara të nisë Liga B (ku do të luanin futbollistët që nuk gjejnë hapësirë të mjaftueshme në ekipet e para), por meqenëse vetëm Ballkani kishte shprehur interesim për atë ligë, ajo nuk arriti të implementohet. Megjithatë, kësaj radhe Liga U21 është obliguese për të gjitha klubet e Superligës dhe, si e tillë, do të nisë së zbatuari nga edicioni i ri. Prandaj, FFK u kërkon klubeve që sa më herët të fillojnë përgatitjet për organizimin e ekipeve U21, ngaqë krijimi i kësaj lige, edhe sipas ekspertëve të fushës, vlerësohet shumë i rëndësishëm për përparimin e mëtutjeshëm të cilësisë së Superligës dhe futbollit tonë në përgjithësi.

## Zërina Shatri, MVP e javës në basketboll

Prishtinë, 30 janar - Në xhiron e 14-t në Superligën e Femrave, Prishtina arriti ta fitojë derbin ndaj Penzës, 74:67. Për fitoren e Prishtinës më së shumti kontribuoi Zërina Shatri me 13 pikë, dhjetë kërcime dhe dy asistime. Qendra Shatri ishte më e mira e kësaj ndeshjeje dhe kësaj jave. Për fitoren e Prishtinës kontribuoi edhe Agnesa Rrahmani me 12 pikë, tri kërcime dhe tri asistime. Në anën tjetër, fitoren e parë në këtë edicion e ka arritur edhe Vëllaznimi me rezultat të ngushtë 52:51 ndaj United Basketboll.

Fitores së parë të skuadrës nga Gjakova më së shumti i kontribuoi Tianna Sullivan me dyshifror të dyfishtë, dhjetë pikë, 11 kërcime dhe një asistim. Lideri Bashkimi ka regjistruar fitoren e 14-t në po aq ndeshje, sa edhe ka zhvilluar.

Prizrenaset këtë javë kanë mposhtur Trepçën me rezultat 54:69. Më të mirat e vajzave të Prizrenit ishin Taliyah Hopkins me 22 pikë, 10 kërcime dhe tri asistime dhe Aulona Muhadri me 20 pikë, 12 kërcime dhe një asistim.

TOPPESËSHJA		
Zërina Shatri	(Prishtina)	13 pikë, 10 kërcime, 2 asistime
Agnesa Rrahmani	(Prishtina)	12 pikë, 3 kërcime, 3 asistime
Taliyah Hopkins	(Bashkimi)	22 pikë, 10 kërcime, 3 asistime
Aulona Muhadri	(Bashkimi)	20 pikë, 12 kërcime, 1 asistim
Tianna Sullivan	(Vëllaznimi)	10 pikë, 11 kërcime, 1 asistim



## 'El Classico' në gjysmëfinale të Kupës së Mbretit

**MADRID, 30 JANAR** - Dy rivalët e fortë spanjollë, Barcelona dhe Real Madridi, do të ndeshen edhe një herë tjetër. Kësaj radhe "El Classico"-n e

nxori shorti i Kupës së Mbretit që u hodh të hënën. Takimi i parë gjysmëfinal i Kupës së Mbretit do të zhvillohet në stadiumin "Santiago Bernabeu", kurse

ai i kthimit në stadiumin "Camp Nou". Çifti tjetër gjysmëfinal është ai në mes të Osasunës dhe Athletic Bilbaos. Trofeun e kësaj gare Real Madridi,

Barcelona dhe Athletic Bilabo së bashku e kanë fituar plot 73 herë në histori. Barcelona 31 herë, Athletic Bilbao 23 herë dhe Real Madridi 19 herë.



## Zelensky: Lejimi i rusëve në Olimpiadë nënkupton 'pranim të terrorit'

Kiev, 30 janar - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë se lejimi i Rusisë e cila po e vazhdon agresionin ndaj ukrainasve për të konkurruar në Olimpiadën 2024 që mbahet në Paris, do të nënkuptonte se "terrori në njëfarë mënyre është i pranueshëm". Madje Zelensky ka potencuar se për këtë

çështje ka biseduar edhe me presidentin e Francës, Emmanuel Macron. Sipas tij, Rusia nuk bën të lejohet që Olimpiadën ta përdorë për propagandë. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar ka pohuar se përfaqësuesit rusë dhe bjellorusë mund të garojnë si neutralë në Lojërat Olimpikë.

Por, nëse kjo ndodh, atëherë Ukraina mund ta bojkotojë Olimpiadën. "Ideja për t'i kthyer atletët rusë në Lojërat Olimpikë nënkupton se botës do t'i thuhet se terrori është disi i pranueshëm", ka thënë Zelensky në një videojalim. Ai ka theksuar se Rusia nuk duhet të lejohet t'i keqpërdorë Lojërat Olimpikë dhe ngjarjet

e tjera sportive si propagandë për agresionin e saj ose shovinizmin e saj shtetëror. IOC ka theksuar se atletët rusë dhe bjellorusë mund të konkurrojnë si "atletët neutralë", me arsyetimin se nuk duhet t'u mohohet e drejta e garimit sportistëve shkaku i pasaportës së tyre. Por Zelensky insiston se nuk



mund të ketë neutralitet në sport derisa sportistët e vendit të tij po vriten nga agresioni rus në fushën e betejës.

## Tirana fiton Kupën e Shqipërisë në futsall

TIRANË, 30 JANAR - Kupa e Shqipërisë në futsall 2023 u përmbyll të dielën me finalen e madhe në mes të Diamanti Futsal dhe Tirana Futsal, sfidë e luajtur në kompleksin Goga në Durrës. Ndeshja u ndjek nga një numër i kënaqshëm spektatorësh, ndërkohë që në fushë Tirana Futsal ishte gjatë gjithë kohës superiore dhe fitoi bindshëm me rezultatin 5-0. Protagonistët e këtij suksesi me golat e tyre ishin Kaca (tregolësh), Mërtiri dhe Xhaferraj. Në ndeshje u dhuruan çaste mjaft të bukura duke konfirmuar edhe një herë rritjen e futsalit dhe kompeticioneve të organizuara nga FShF-ja. Tirana Futsal fitoi trofeun e Kupës së Shqipërisë 2023, teksa në fund u organizua edhe ceremonia e rastit me drejtorin e Futbollit Amator në FShF, Jurgen Demneri dhe specialistin e këtij sektori, Igli Mumajesi, të cilët ua dorëzuan medaljet dhe trofeun fituesve.



Në këtë edicion të Kupës së Shqipërisë në Futsall morën pjesë tetë skuadra: Flamurtari Futsal, Vllaznia Futsal, Tirana Futsal, Diamanti Futsal, Eagles Land, Olimpik 1 Maji, Forcat e Armatosura dhe Olimpik Tirana. Të njëjtat skuadra marrin pjesë edhe në Kampionatin Kombëtar të Futsallit, ndërkohë që,

krahasuar me sezonin e kaluar, është dyfishuar numri i ekipeve që janë bërë pjesë e kësaj discipline. Objektivi i FShF-së është që sezonin e ardhshëm të ketë edhe më shumë ekipe në këto turne, pasi interesi ka qenë në rritje dhe ka shumë djem të apasionuar pas futbollit që duan të jenë pjesë e futsalit.

## Milwaukee synon kreun e renditjes në Lindje

Milwaukee, 30 janar - Skuadra e Milwaukee's i afrohet gjithnjë e më shumë kreut të renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 135-100 ndaj New Orleans. Ky është suksesi i katërt radhazi për Bucksin, ku u dallua Giannis Antetokounmpo, me 50 pikë e 13 rebounde. Fiton edhe ekipi i Charlottes, që mundi me rezultat 122-177 Miamin, në një ndeshje të ekuilibruar deri në fund. Rozier



me 31 pikë e P. J. Washingtoni me 27 bënë diferencën në fushë për vendasit. Skuadra e Clevelandit, falë 29 pikëve të Cedi Osmanit, që e nisi ndeshjen nga stoli, mposhti 122-99 clippersat. Stoli i Clevelandit

realizoi në total 63 pikë. Memphis rikthehet te fitorja, duke mundur me rezultat 122-100 Indianan, me Ja Morant protagonist, autor i një "triple double", me 27 pikë, 10 rebounde e 15 asistime.

### REZULTATET

Charlotte - Miami	122-117
Memphis - Indiana	112-100
Cleveland - Clippers	122-99
Milwaukee - New Orleans	135-110

## Barça e interesuar për ta rinovuar kontratën me Dembeles

Barcelona është e interesuar për të rinovuar me yllin Ousmane Dembele, raporton "Sport". Ish-lojtari i Borussia Dortmundit ka

qenë gjithmonë një pikë shqetësimi për skuadrën spanjolle që nga ardhja e tij nga Gjermania për shkak të lëndimeve të tij.

Marrëveshja aktuale e Dembeles përfundon në vitin 2024, por gjigantët katalanas janë duke u përgatitur për t'i zhvilluar

bisedimet rreth rinovimit të kontratës. Në anën tjetër, PSG-ja ka treguar interesim për asin francez për faktin se ka klauzolë lirimi vetëm 50

milione euro. Mbetet të shihet nëse do të arrihet një marrëveshje ndërmjet tyre për ta vazhduar bashkëpunimin.

### SHKURT

#### Ancelotti: Pesë pikë shkëputje nga vendi i parë është dëshpëruese

Real Madridi ka barazuar ndaj Real Sociedadit (0-0). Trajneri Carlo Ancelotti ka thënë se shkëputja e Barcelonës prej pesë pikëve nga ekipi i tij është mjaft dëshpëruese. "Është turp. Ne merituar të fitonim. Bëmë një ndeshje të plotë. Skuadra po përmirësohet edhe fizikisht. Ishim afër golave, por në fund morëm një barazim. Me pesë pikë shkëputje nga vendi i parë jemi të dëshpëruar", ka deklaruar Ancelotti.

#### Alvesi nga burgu: Do ta pranoj çfarëdo që do të ndodhë

Dani Alves është duke qëndruar i mbyllur që nga 20 janari në burgun Brians 2 në Sant Esteve Sesrovires. Ish-futbollisti i Barcelonës akuzohet se e përdhunoi një femër 23-vjeçare në natën e 30 dhjetorit. Përfaqësuesi i deritashëm brazilian i ka dhënë deklaratat e para nga burgu, duke qenë në dispozicion ta pranojë çdo vendim që do të merret nga gjykata. "Do ta pranoj çfarëdo që do të ndodhë. Kam dalë nga shtëpia ime kur isha 15-vjeçar. Kam kaluar situata mjaft të vështira dhe të komplikuar në jetën time, do të kalojë edhe kjo. Asgjë nuk më zbraps", ka thënë ish-futbollisti i Juventusit, i cili ishte duke kaluar vitet e fundit të karrierës. Alvesi pritet t'i kalojë disa vjet burg për përdhunim, ndërsa në dhomat e paraburgimit i ka dhënë disa versione të ngjarjes të asaj nate.

#### Katër alternativa për Zidanen

Zinedine Zidane ka nisur të kërkojë një skuadër të re. Shpresat e tij ishin të merre drejtimin e Francës. Por rinovimi i federatës franceze me trajnerin aktual Didier Deschamps deri në vitin 2026 ka bërë që Zizu të mendojë t'i kthehet përsëri stolit të ndonjë klubi. Sipas medieve spanjolle dhe atyre franceze, janë katër alternativa për ish-trajnerin e Realit të Madridit. Alternativa e parë është Paris SG-ja, edhe pse emërimi i Kristof Galtie është i freskët. Shumë gjëra në fakt do të vendosen nga ecuria e parisienëve në Ligën e Kampionëve. Alternativa e dytë për Zidanen është Juventusit. Opsioni i tretë, edhe pse më i largët në dukje, është Bayern Muncheni, teksa mundësia e fundit është një rikthim i mundshëm te Reali i Madridit.

#### Interi e kërkon Maguiren në formë huazimi

Interi është i interesuar për ta marrë Harry Maguiren nga Manchester Unitedi. Megjithatë, sipas raportimeve nga "Daily Mail", kapiteni i "Djajve të Kuq" do të dëshironte ta priste verën për t'u larguar nga "Old Trafford", ndërsa zikaltrit e kanë me nxitim pasi dëshirojnë ta gjejnë zëvendësuesin e Skriniar i cili do të largohet për te PSG-ja. Interi kërkon ta marrë huazim Maguiren, megjithatë nuk ka gjasa që mbrojtësi anglez të lëvizë në janar sepse në fund të sezonit do t'i vlerësojë ofertat nga klubet e tjera, gjë që përkon edhe me dëshirat e Manchester Unitedit.



**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "AMBIENTI" SH.A  
LOCAL PUBLIC ENTERPRISE "AMBIENTI" J.S.C  
LOKALNO JAVNO PREDUZEĆE „AMBIENTI“ A.D**

Adresa: Zyrtar qendrore Rr. Xhem Sadrija p.n, 30000 PEJË  
Email: [krm.ambienti@yahoo.com](mailto:krm.ambienti@yahoo.com)

Në bazë të nenit 21 të Ligjit numër 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 15.06.2008), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-111 (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 30.05.2012), nenit 15 paragrafi 2.2 pika (Dh) të Statutit të NPL "Ambienti" Sh.A., Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 27.01.2023, vendosi të Ri shpall ketë:

**K O N K U R S**

Pozita: **Zyrtar/e Kryesor Financiar dhe i Thesarit**

Kohëzgjatja e mandatit: 3 (tre) vite – me mundësi vazhdimi  
**I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv  
**Orari i punës:** I plote  
**Vendi:** Pejë

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimin të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Kandidati/ja duhet të ketë diplomë universitare me të paktën 240 kredi/ECTS ose master, në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante. Diplomati nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë së paku 3 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes, industri ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku 3 vite.
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në bazë të cilave raporton Ndërmarrja.
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Në mos jetë i dënuar ose nën hetime;
- Një program zhvillimor për kompaninë.

**Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:**

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;
- Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitetet si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të përgatis të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- Mbanë përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;
- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE dhe Bordin e Drejtorëve.
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKF i përgjigjet: Bordit të Drejtorëve, kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

**Procedura e aplikimit:**

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia)
- Letër motivuese
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional (diplomën) – kopje
- Dëshmitë për përvojën e punës - (Kontrata) - kopje
- Programi zhvillimor për kompaninë ne aspektin e menaxhimit të financave.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 1 muaj – origjinale;
- Deklarata nën betim; **(merret brenda ndërmarrjes ne kopje fizike para se te dorezohet aplikacioni)**
- Letërnjoftimi - kopje;

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data e shpalljes se konkursit me dt. 31.01.2023 deri më 02.03.2023 ora 16:00.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitën: Zyrtar kryesor Financiar dhe i Thesarit i NPL "Ambienti" Sh.a.

Kërkesat e dorëzuara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur që i plotësojnë kushtet do të ftohen në intervistë.

Kërkesat-Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kandidatët me dokumentacion të pa-kompletuar, të pa-plotësuar dhe joadekuat do të refuzohen.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Apocryphon" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811439844 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Apocryphon" L.L.C. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811439844 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "Apocryphon" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811439844 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Bio Shop Medina shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit ,e nr. 810051607..

- Hana Rexhaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik, të UP-së, Prishtinë.

- Burhan Gashi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Dardan Pjetraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Agron Krrakaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së 10-të të shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



**D P A**  
Departamenti për punë administrative  
Mitrovicë / Nr.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë këtë:

## K O N K U R S

- **Për plotësimin e vendeve të lira të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi.**

**I. Pozita e punës:** Drejtor Komercial.

**Kompania:** Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë.

**Paga bazë:** 991.25 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

### Kushtet për punësim (edukimi i kërkuar):

**Përgatitja profesionale:** Titulli "Master", në drejtimet (Ekonomik, Menaxhment, Administrim Biznesi).

**Përvoja e punës:** Tri (3) vite përvojë pune, prej tyre së paku dy (2) vite punë menaxheriale në një rol të lartë udhëheqës në shitje, marketing dhe/ose përvojën e mëpareshme si Drejtor Komercial.

**Pozita e hapur:** Një (1) Drejtor Komercial.

### Kushtet e veçanta:

- ✓ Njohuri të larta të raportimit të performancës dhe proceseve financiare/buxhetore,
- ✓ Të jetë shumë i orientuar drejt qëllimeve dhe zotëroj aftësi të shkëlqyera ndër personale dhe komunikuese,
- ✓ Aftësi të shkëlqyera organizative dhe udhëheqëse,
- ✓ Njohja e punës me kompjuter, programe softuerike (aplikacione) që funksionojnë në kuadër të Ndërmarrjes.

### Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Drejton, organizon dhe zbaton punët dhe detyrat e caktuara në kompani në Departamentin Komercial si dhe të Marrëdhënies me konsumatorët dhe çështjet specifike (Faturimi, Inspektimi),
- Udhëheq dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate efektive,
- Drejton dhe përgatitë të dhënat komerciale të kompanisë për planin e biznesit,
- Shqyrton dhe aplikon procedurat e aprovuara për sektorin komercial,
- Koordinon, kontakton dhe bashkëpunon në ofrimin e të gjitha të dhënave të aktivitetit të departamentit në varësi,
- Analizon klimën e treguesve dhe tendencat e biznesit në aspektin komercial për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike për të ardhmen,
- Interpretin informacionin sektorial për të siguruar raportet e nevojshme për vendim-marrje,
- Monitoron procesin e faturimit dhe shitjeve, nivelin e performancës në njësit vartës, llogaritë e arkëtueshme,
- Sipas autorizimeve të KE-se përfaqëson Ndërmarrjen përpara palëve të interesit,
- Sipas kërkesave përpilon raporte mujore dhe vjetore për ARRU dhe institucione qeveritare,
- Është pjesë ndërlidhëse midis departamentit dhe njësitë e tjera,
- Kryen detyra të tjera, me ZKF-ne koordinon aktivitetet rreth mirëmbajtjes së llogarive të arkëtueshme dhe kryen detyra të caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv, sipas fushës së kompetencës dhe pozitës,
- Për punën që e kryen i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

**II. Pozita e punës:** Shef i Cilësisë së Ujit dhe Burimeve.

**Kohëzgjatja e kontratës së punës:** 6 muaj punë provuese me mundësi vazhdimi.

**Orari:** I plotë.

**Vendi i punës:** Mitrovicë (Regjional).

**Paga bazë:** 677.57 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

### Kualifikimet dhe aftësitë:

**Përgatitja profesionale:** Titulli "Master", në drejtimet (Kimi, Mikrobiologji, Teknologji);

**Përvoja e punës:** Tri (3) vite përvojë pune si (Laborant).

**Pozita e hapur:** Një (1) Shef i Cilësisë së Ujit dhe Burimeve.

### Kushtet e veçanta:

- ✓ Të zotëroj aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese,
- ✓ Aftësi të shkëlqyera organizative dhe udhëheqëse,
- ✓ Njohja e gjuhës angleze (e preferueshme)
- ✓ Njohja e punës me kompjuter, programe softuerike (aplikacione) që funksionojnë në kuadër të Ndërmarrjes.

### Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Bënë menaxhimin e cilësisë së ujit të destinuar për konsum njerëzor përmes analizimit të parametrave të rregulluara me legjislacionin në fuqi për ujin e pijshëm;

- Mbikëqyrë punën e laborantëve dhe mostrueseve në zbatimin e planit operacional dhe jep rekomandimet e nevojshme në sigurimin e cilësisë organizon dhe mbikëqyrë të gjitha punët që kanë të bëjnë me cilësinë e ujit që furnizohet përmes sistemit të ujësjellësit i cili menaxhohet nga KRU Mitrovica në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë burimet e ujit, impiantet e trajtimit, rezervuarët, rrjetin shpërndarës deri të konsumatori;
- Menaxhon dhe është përgjegjës për punën e stafit i cili punon në marrjen dhe testimin e mostrave të ujit në laboratorin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik të KRU Mitrovica, ku përmes analizave të bëra konstatohet cilësia e ujit;
- Është përgjegjës për hartimin e Planit të Monitorimit Operacional i cili duhet të jetë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi për cilësinë e ujit të pijshëm (aktualisht nr. 10/2021 Për Cilësi të Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor) dhe në konsultim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike;
- Në bazë të planit operacional përcakton frekuencën e mostrimit dhe vendin e marrjes së mostrave të ujit në ITU dhe në sistemin e ujit.
- Kontrollon punën ditore për cilësi të ujit në ITU dhe në sistemin shpërndarës të ujit dhe përgaditë raporte të punës ditore dhe periodike;
- Kujdeset për sigurimin e kushteve optimale për punën e laboratorit përfshirë furnizimin me kohë të reagencave, mjeteve të punës, mjeteve mbrojtëse dhe paisjeve laboratorike;
- Merr pjesë në emër të KRU Mitrovica në takime, punëtori dhe forume tjera me pale relevante të interesit;
- Bashkëpunon ngushtë me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHP) si dhe institucionet tjera në adresimin e çështjeve dhe problemeve tjera lidhur me cilësinë e ujit të pijshëm përfshirë edhe Shoqatën e Ndërmarrjeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve (SHUKOS), Këshillin Ndërmarrës për Ujëra (KNMU), Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU) dhe njëherë zbaton rekomandimet e tyre;
- Bashkëpunon ngushtë me departamentin teknik (drejtorin teknik, menaxherat e impiantit dhe menaxherat e sistemit shpërndarës të ujit dhe të njërive operative të KRU Mitrovica) dhe jep rekomandimet e nevojshme profesionale për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm sipas standardeve të kërkuara;
- Kujdeset për gjendjen e sistemit shpërndarës të ujit dhe gjendjen e rezervuarëve akumuluese me uji dhe jep rekomandimet profesionale dhe preventive në eliminimin e defekteve dhe shmangie të rreziqeve të vërejtura të cilat mund të ndikojnë në dëmtimin e cilësisë së ujit;
- Bashkëpunon ngushtë me të gjitha departamentet dhe njësit në nivel të Kompanisë;
- Merr masat mbrojtëse dhe paralajmëruese për mbrojtjen e burimeve të ujit (kufizimin e zonave mbrojtëse me rrethojë dhe vendosjen e shenjave paralajmëruese në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e burimeve të ujit të pijshëm aktualisht UA nr. 15/2017 për Kriteret për Caktimin e Zonave Sanitare të Burimeve të ujit);
- Monitoron gjendjen e zonave mbrojtëse të burimit, bën vlerësimin faktik të gjendjes ekzistuese dhe rekomandon masat që sipas nevojës duhet të ndërmerren;
- Siguron që kompania të zbatojë obligimet ligjore të përcaktuara në Ligjin për Ujëra, aktet nënligjore dhe aktet tjera normative sa i përket mbrojtjes së burimeve të miratuara nga institucionet përgjegjëse (Qeveria, Ministria e mjedisit etj);
- Bashkëpunon ngushtë me inspektoratin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe organet komunale për zbatimin e masave mbrojtëse për mbrojtje të burimeve të ujit;
- Monitoron gjendjen e mbrojtjes së zonës së furnizimit nga e cila furnizohet Impianti i Trajtit të Ujit dhe burimeve të sistemeve të vogla të cilat janë në menaxhimin e KRU "Mitrovica" sh.a. dhe sipas nevojës merr masat e duhura;
- Për punën që e kryen i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

### Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Një deklaratë nën betim (për pozitën: Drejtor Komercial).
- Kopja e letërnjoftimit.

Aplikacionet mund të merrën ueb-faqën e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.a. në adresën:

<http://www.kru-mitrovica.com/kerko-me-shume/konkurset/>, si dhe në zyrën për burime njerëzore dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin percjellës në formë fizike apo përmes emailit zyrtar: burime.njerzore@kru-mitrovica.com

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Dokumentet e pranuar të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatet nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë.

KRU "Mitrovica" Sh.A.Mitrovicë.



D A P  
Department za Administrativne Poslove  
Mitrovica Br

Na osnovu Administrativnog uputstva br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće "Mitrovica" d.d. u Mitrovici, objavljuje:

### K O N K U R S

- Za popunu upražnjenog radnog mesta, probni rad u trajanju od šest (6) meseci sa mogućnošću produženja.

#### I. Radno mesto: Komercijalni Direktor.

**Kompanija:** Regionalna Kompanija Vodovod „Mitrovica“ D.D. u Mitrovici.

Osnovna plata će biće 991.25 Euro po uredbi o raspodeli prihoda.

#### Uslovi za zapošljavanje (potrebno obrazovanje)

**Stručna sprema:** Maester (Ekonomija, Menadžment, Poslovna Administracija)

**Radno iskustvo:** 3 godina radnog iskustva, od kojih najmanje 2 godine menadžerski rad u ulozi višeg rukovodioca u prodaji, marketingu ili ranije iskustvo kao Komercijalni Direktor.

**Otvorena pozicija:** Jedan (1) Komercijalni Direktor.  
**posebni uslovi;**

- ✓ -Visoko poznavanje izveštavanja performanse i finansijskih/budžetskih procesa,
- ✓ -Da bude veoma orijantisan ka cilju i imati odlične međuljudske komunikacijske veštine,
- ✓ -Odlične organizacione i rukovodeće sposobnosti,
- ✓ -Poznavanje rada sa kompjuterom, softverskim programima (aplikacije) koje funkcionišu u okviru Preduzeća.

#### **Radne obaveze i odgovornosti:**

- Da bude sposoban/na za obavljanje radnih obaveza sa punim radnim vremenom i bez ograničenja,
- Da usmerava, organizuje i realizuje poslove i zadatke u preduzeću u Sektoru Komercijale, kao i donose sa potrošačima i specifična pitanja (fakturisanje, inspekcija sa potrošačima),
- Da vodi i savetuje svo podređeno osoblje kako bi osigurali efektivne rezultate,
- Da upravlja i pripremi komercijalne podatke kompanije za poslovni plan,
- Da pregledai procenjuje odobrene procedure za komercijalni sektor,
- Da koordinira, kontaktira i saraduje u pružanju svih podataka o aktivnostima predređenog odeljenja ,
- Da analizira komercijalnu klimu i poslovne trendove marketinških stručnjaka kao bi pomogli višim rukovodiocima u kreiranju strateških planova za budućnost,
- da tumači sektorske informacije kako bi obezbedio neophodne izveštaje za donošenje odluka,
- Da prati proce fakturisanja i prdaje, nivo učinka u podređenim jedinicama, potraživanjima,
- Da po ovlašćenjima EK zastupa Preduzeće pred zainteresovanim strankama,
- Da prema zahtevima izradi mesečne i godišnje izveštaje za ARRU i vladinih institucija,
- Da je deo za vezu između odeljenja i drugih jedinica,
- Da izvrši druge zadatke, sa ZKF koordinira aktivnosti oko održavanja potraživanja i da završi određene zadatke od strane glavnog Izvršnog Direktora, prema oblasti nadležnosti i položaja,
- Za poslove koje izvršava odgovara izvršnom Direktor.

#### II. Naziv radnog mesta: Šef Kvaliteta Voda i Resursa

**Trajanje ugovora o radu:** 6 meseci probnog rada sa mogućnošću produženja.

**Raspored:** Puno radno vreme.

**Mesto rada:** Mitrovica (Regionalni).

Osnovna plata će biće 677.57 Euro po uredbi o raspodeli prihoda.

#### Kvalifikacije i veštine:

**Stručna sprema:** Master (hemija, mikrobiologija, tehnologija);

**Radno iskustvo:** 3 godine radnog iskustva (Laboratorijski tehničar)

**Otvorena pozicija:** Jedan (1) Šef Kvaliteta Voda i Resursa.

#### **Posebni uslovi:**

- ✓ Posedovanje odlične međuljudske i komunikacijske veštine,
- ✓ Odlične organizacione i liderske sposobnosti,
- ✓ Poznavanje engleskog jezika (poželjno)
- ✓ Poznavanje rada na računaru, softverskih programa (aplikacija) koji rade u okviru Preduzeća.

#### Poslovi i odgovornosti:

- Je sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja,
- Upravlja kvalitetom vode namenjene za ljudsku upotrebu kroz analizu parametara regulisanih važećim zakonodavstvom za vodu za piće;
- Nadgleda rad laboratorijskih tehničara i uzorkovača u sprovođenju operativnog plana i daje potrebne preporuke u obezbeđivanju kvaliteta, organizuje i nadgleda sve poslove u vezi sa kvalitetom vode koja se snabdeva preko vodovoda kojim upravlja RVP Mitrovica u skladu sa zakonima na snazi, uključujući izvore vode, postrojenja za prečišćavanje, rezervoare, distributivnu mrežu do potrošača;
- Rukovodi i odgovara za rad osoblja koje radi na uzimanju i ispitivanju uzoraka vode u fizičko-hemijskoj i mikrobiološkoj laboratoriji RVP Mitrovica, gde se kvalitet vode utvrđuje kroz izvršene analize;
- Odgovoran je za izradu Operativnog plana monitoringa, koji mora biti u skladu sa odredbama važećeg zakonodavstva o kvalitetu vode za piće (trenutno br. 10/2021 o kvalitetu vode za ljudsku potrošnju) iu konsultaciji sa Nacionalnim institutom za javno zdravlje;
- Na osnovu operativnog plana utvrđuje učestalost uzorkovanja i lokaciju uzorkovanja vode u ITU iu vodovodnom sistemu.
- Proverava svakodnevni rad za kvalitet vode u ITU i sistemu za distribuciju vode i priprema dnevne i periodične izveštaje o radu;
- Brine o obezbeđivanju optimalnih uslova za laboratorijski rad, uključujući blagovremeno snabdevanje reagensima, radnim alatima, zaštitnom opremom i laboratorijskom opremom;
- Učestvuje u ime KRU Mitrovica na sastancima, radionicama i drugim forumima sa relevantnim zainteresovanim stranama;
- Blisko saraduje sa Nacionalnim institutom za javno zdravlje (NIJZ) kao i drugim institucijama u rešavanju pitanja i drugih problema u vezi sa kvalitetom vode za piće, uključujući Udruženje preduzeća za vodosnabdevanje i kanalizaciju (UPVSK), Međuministarski savet za vode (MMSV), Regulatorni organ za vodne usluge (ROVU) i odmah sprovodi njihove preporuke;
- Usko saraduje sa tehničkim odeljenjem (tehnički direktor, rukovodioci postrojenja i rukovodioci sistema za distribuciju vode i operativnih jedinica RVP Mitrovica) i daje potrebne stručne preporuke za obezbeđivanje kvaliteta vode za piće u skladu sa potrebnim standardima;
- Brine o stanju vodovodnog sistema i stanju rezervoara za vodu i daje stručne i preventivne preporuke za otklanjanje kvarova i izbegavanje uočenih rizika koji mogu uticati na kvalitet vode;
- blisko saraduje sa svim odeljenjima i jedinicama na nivou Preduzeća;
- Preduzima mere zaštite i upozorenja za zaštitu izvorišta (ograničavanje zaštitnih površina ogradom i postavljanje znakova upozorenja u skladu sa važećom zakonskom regulativom za zaštitu izvorišta vode za piće trenutno UA br. 15/2017 o kriterijumima za određivanje Sanitarne zone izvorišta);
- Prati stanje zaštićenih dobara, vrši faktičku procenu postojećeg stanja i preporučuje mere koje je potrebno preduzeti;
- Obezbeđuje da preduzeće sprovodi zakonske obaveze definisane Zakonom o vodama, podzakonskim aktima i drugim normativnim aktima u pogledu zaštite resursa odobrenih od strane nadležnih institucija (Vlada, Ministarstvo životne sredine, itd.);
- Blisko saraduje sa Inspekcijom za životnu sredinu i prostorno planiranje i opštinskim organima za sprovođenje zaštitnih mera zaštite vodnih resursa;
- Prati stanje zaštite područja snabdevanja sa kojeg se snabdeva postrojenje za prečišćavanje vode i izvorišta malih sistema koji su pod upravom RVP „Mitrovica“ d.d i po potrebi preduzima odgovarajuće mere;
- Odgovoran je glavnom izvršnom direktoru za posao koji obavlja.

#### Traženi dokumenti:

Zainteresovani kandidati moraju da popune prijavu Kompanije i da uz ovu prijavu prilože sledeću dokumentaciju:

- CV (biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitetska diploma (overena kopija, dok diplome sa univerziteta u inostranstvu moraju biti overene kod notara),
- Dokaz nadležnog suda koji nije pod istragom, koji važi najviše 6 meseci,
- Dokaz o stručnoj obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Izjava pod zakletvom (za poziciju: komercijalni direktor).
- Kopija lične karte,

Prijave se primaju na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi <http://www.kru-mitrovica.com/kerko-me-shume/konkurset/>, kao i u kancelariji za ljudske resurse i dostavlja se istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom, ili službenom poštom: burime.njerzore@kru-mitrovica.com

Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja u medijima.

Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju.

Prihvaćena fotokopirana dokumenta podnosiocima prijava se ne vraćaju.

Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidate iz manjinskih grupa, kao i osobe sa invaliditetom da se prijave.

RVP „Mitrovica“ d.d. Mitrovica.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten  
free



cilësi e garantuar

pa konservues